



Asistencë
rrugore
Roadside
assistance
Tel: +355 44 522 666

AutoSOS

Policë Sigurimi | Insurance Policy
Asistencë rrugore 24/7 | Roadside assistance 24/7



Të dhënat e policës AutoSOS Policy data	Nr. serial i policës / Policy Serial No. Periodha e sigurimit: Data e fillimit Insurance Period: Inception date e mbarimit Data Expired date				QR CODE
Të dhënat e sigurimit të mjetit motorik Motor Insurance Data	☐ TPL MTPL ☐ Karton Jeshil Green Card ☐ Kufitare Border ☐ Kasko Casco Nr. serial i policës / Policy Serial No. Periodha e sigurimit: Insurance Period: Data e fillimit Inception date e mbarimit Data Expired date				
Të dhënat e të siguruarit Details of the Insured	Emri Mbiemri / Name Surname ID Datëlindje / Date of Birth e-mail Cel / Mob Adresa / Address				
Të dhënat e automjetit Vehicle data	Targa / Plate No. Kategoria Category Klasa / Class Marka / Brand Modeli / Model				


Ngjyra / Color

Viti
Prodhimit
Year of
Production

Nr. i Shasisë / Chassis Number

Nr. i vendeve
No. of seatsKapaciteti
mbajtës
Carrying
capacityFuqia motorike
Motor capacity

Deklarata e te Siguarit: Deklaroj se gëzoj shëndet të plotë, pa defekte ose dobësi fizike, si dhe kam lexuar, njohur, kuptuar dhe pranuar kushtet e kësaj kontrate sigurimi. Deklaroj se kam njohur, pranuar dhe miratuar të gjitha kufizimet për përgjegjësitë, mundësinë për t'u tërhequr nga kontrata si dhe çdo kufizim kontraktor të parashikuar në këtë kontratë nga Siguruesi. Në rast se deklarata ime rezulton e pasaktë, përjashtohem nga çdo përfitim sipas këtij sigurimi. Jap pëlqimin për transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale dhe sensitive për qëllime të sigurimit dhe risigurimit. Në çdo rast përpunimi i të dhënave bazohet në përpunimin në mënyrë të ndershme, të drejtë dhe të ligjshme (Ligji Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale"). Mbi sa deklaruar më sipër, miratoj me nënshkrimin tim.

I Siguruar Insured Emër, Mbiemër, Firmë / Name, Surname, Signature	Dega/Agjenti Branch / Agent	Administrator i Përgjithshëm General Administrator AVNI PONARI 
SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A. Auorizim nr. 2 dt. 23.06.1999, NIPT J91809007H, Kodi Fiskal 370893 Adresa: SIGAL Business Center, Blv. "Zogu I", Nr. 1, 1001, Tiranë, Shqipëri		 Asistencë rrugore 24/7 Roadside assistance 24h/d7 Tel: +355 44 522 666

Kushtet e Kontratës së sigurimit AutoSOS

Neni 1 Objekti i Sigurimit

1.1 Kontrata AutoSOS, mbulon shërbimet e asistencës rrugore në vendet e Europës dhe Ballkanit, në rast aksidenti rrugor ose defekti teknik në mjet ose bllokim rruge nga moti i keq, kur këto kushte lejojnë ofrimin e shërbimit të kërkuar. **1.2** Shërbimet e asistencës rrugore të parashikuar në pjesën e përparme të kësaj kontratë (policën AutoSOS), mbulohen dhe ofrohen përgjatë periudhës së mbulimit në sigurim, nga ora 24.00 e datës së shënuar në policë si datë fillimin deri ne oren 24.00 të datës së shënuar në policë si datë mbarimi, përveç rastit të parashikuar në nenin 4 pika 2 të kësaj kontrate. Mbulohen vetëm shërbimet që janë përzgjedhura në kolonën përkatëse të kësaj kontrate (mbulimet) dhe nëse primi i policës AutoSOS është paguar përpara datës së kërkesës për shërbim të asistencës rrugore. **1.3 Shërbimet e mbuluara: a. Qendra e kontaktit 24/7-** ky shërbim përfshin dhënien e informacionit, rekomandimeve, këshillimeve dhe asistences orientuese në rrugë telefonike, në çdo kohe, pa limit. Ky shërbim nuk përfshin mbulimin e ndonjë shpenzimi. **b. Riparim në vend-** ky shërbim mbulon defekte si ndërrim gome rezervë, probleme me baterine të tilla që mund të zgjidhen në vënd, në mjetin me defekt. Në keto raste mbulohen shpenzimet e shërbimit deri në totalin dhe frekuencën e përcaktuar në policë për atë shërbim në kolonën "limitet". Shpenzimet për materialet (pjesët që zëvendësohen), bateri ose gomë etj, mbulohen nga vetë klienti. **c. Karroatrec-** ky shërbim mbulon shpenzimet dhe marrjen e mjetit me karroatrec dhe spostimit të tij në servisin ose parkingun më të afërt (limiti në kilometra i transportit me karroatrec do të jetë dhe në vlerën monetare qe mbulohen nga siguruasi, përcaktohen në policën e sigurimit AutoSOS). **d. Zëvendësimi i automjetit në rast aksidenti-** ky shërbim ofrohet vetëm në rastet kur mjeti përshihet në aksident dhe është në pamundësi për të lëvizur deri në servisin apo parkingun më të afërt. Ky shërbim mbulon shpenzimet e zëvendësimit të mjetit, kur mjeti i dëmtuar nuk riparohet dot brenda 24 orëve nga momenti i dhenies së shërbimit me karroatrec, dhe aksidenti ka ndodhur në një distancë mbi pragun limit të përcaktuar në police, nga vendbanimi i shoferit (distanca minimale përcaktohet në policë). Në këtë rast mbulohet shpenzimi për qiranë e mjetit për një ditë. Vlera limit e qirasë ditore përcaktohet në policë. Kostot e kthimit të mjetit dhe ndonjë kosto tjetër transporti, nuk mbulohen. **e.Akomodimi në hotel-** Ky shërbim mbulon shpenzimet e akomodimit në hotel te drejtuesit te mjetit, në rast të përfshirjes së mjetit në një aksident dhe pamundësi lëvizje dhe në rast se riparimi i mjetit është i pamundur brenda 24 orëve si dhe distanca e vëndit në të cilën ka ndodhur aksidenti është mbi limitin e përcaktuar në policë nga vëndqëndrimi drejtuesit të mjetit. Përveç drejtuesit të mjetit në momentin e ndodhjes së aksidentit të mjetit të siguruar me AutoSOS, akomodim në hotel përfitojnë edhe pasagjerërt që mund të ndodhen në mjet (deri në numrin maximal të pasagjerëve që lejon mjeti), në momentin e ndodhjes së aksidentit. Vlera maximale e mbulimit përcaktohet në policë e sigurimit AutoSOS. **f. Transport Alternativ-** ky shërbim mbulon në masën e caktuar në policë shpenzimet për vazhdimin e udhëtimit deri në destinacion, me transport publik, me tren, avion, taksi ose kthimin (riatdhesimin) me tren ose avion. 1.4Shërbimet e parashikuara në pikën 1.3, shkronjat d), e) dhe f, nuk janë kumulative, pra vetëm njëri prej tyre në një rast mund të aplikohet dhe vetëm në një rast mund të mbulohen shpenzimet.

Neni 2 - Ofruesi i shërbimit

2.1 Shërbimet e mbuluara nga policia AutoSOS ofrohen për të siguruarit e SIGAL deri në masën dhe sipas parashikimeve të kushteve të kësaj kontratë. Shërbimet ofrohen nga SIGAL nëpërmjet partnerëve të saj në Shqipëri si dhe në të gjitha vëndet Europiane, përjashtuar Rusinë, Bjellorusinë dhe pjesen aziatike të Turqisë. **2.2** Call center i SIGAL pergjigjet në telefon në çdo kohë, 24/7 duke i dhënë klientit të siguruar me AutoSOS konsulentën teknike të specializuar, lidhur me asistencën në rrugë, servisin më të afërt, piken më të afërt të karburantit, spitalin apo klinikën më të afërt. **2.3** SIGAL ofron të gjitha shërbimet e tjera të parashikuara në kontratë, sipas rastit dhe përzgjedhjes nga vetë klienti, kur plotësohen kushtet e parashikuara në kontratën AutoSOS për secilin shërbim, sipas limiteve të përcaktuar në kontratë.

Neni 3 – Përfituesit

3.1 Përfitues të shërbimit të asistencës rrugore janë pronari ose drejtuesi i mjetit të siguruar që lidhin këtë kontratë me shoqërinë dhe paguajnë primin e policës përpara datës së ndodhjes së kërkesës për shërbim të asistencës rrugore. 3.2 Përfitues është pronari ose drejtuesi i mjetit në momentin e ndodhjes së ngjarjes aksidentale ose të defektit të mjetit, nëse ngjarja ka ndodhur brënda afateve të mbulimit të kontratës.

Neni 4 - Afati i mbulimit

4.1 Kontrata me mbulim territorin e Shqipërisë është e vlefshme duke filluar nga ora 24.00 e datës së shënuar në policën AutoSOS si datë fillimi, deri në orën 24.00 të datës së shënuar në policë si datë mbarimi, pavarësisht nga afati i policës së sigurimit MTPL, Kufitare apo Kasko me të cilën mund të lidhet kjo policë. Policia AutoSOS me mbulim territorin e Shqiperisë nuk mund te fillojë me herët se 5 ditë nga data e lëshimit të policës (pra data e fillimit të policës AutoSOS nuk mund të jetë më e hershme se 5 ditë nga data e lëshimit të saj). Kjo periudhë nuk aplikohet në rastin e rinovimit të policës AutoSOS. 4.2 Kontrata me mbulim territorin Europës ose me mbulim Rajonal (Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut) është e vlefshme duke filluar nga ora 24.00 e datës së shënuar në policën AutoSOS si datë fillimi, deri në orën 24.00 të datës së shënuar në policë si datë mbarimi, pavarësisht nga afati i policës së sigurimit Karton Jeshil apo Kasko me të cilën mund të lidhet kjo policë. Policia AutoSOS Europë ose AutoSOS Rajonal, nëse kerkohet asistencë nbrenda territorit të Shqiperisë, ka një periudhë pritje 5 ditë nga data e lëshimit të policës. Kjo periudhë pritje nuk aplikohet në rastin e rinovimit të policës AutoSOS. Kontrata është e vlefshme duke filluar nga ora 24.00 e datës së shënuar në policën AutoSOS si datë fillimi, deri në orën 24.00 të datës së shënuar në policë si datë mbarimi, pavarësisht nga afati i policës së sigurimit MTPL, Kufitare, Karton Jeshil apo Kasko me të cilën mund të lidhet kjo policë. Nëse kërkohet asistencë në Shqipëri nga një klinet që disponon AutoSOS me mbulim Europë, ai nuk mund të përfitojë mbulim nëse nuk ka kaluar periudha e pritjes prej 5 ditësh nga data e fillimit te policës.

Neni 5 - Vendet e mbuluara

Kjo policë mbulon shërbimet e parashikuara në policë, në territorin Shqipërisë, ose të Kosovës ose Maqedonisë e Veriut ose territoret e vëndeve të Europës, sipas zgjedhjes që ka bërë i siguruari në kolonën përkatëse të policës AutoSOS. AutoSOS Shqipëri: Mbulon territorin e Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës. AutoSOS Rajonal: Mbulon territorin e Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut. AutoSOS Europë: Mbulon të gjitha vëndet e Europës të listuara mëposhtë, përfshirë Shqiperinë, Kosovën, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, si dhe pjesën europiane të Turqisë; përjashtuar Krimean, Rusinë dhe Bjellorusinë dhe pjesën aziatike të Turqisë. Vëndet e Europës që mbulohen: Andorra, Austria, Belgjika, Bosnia-Herzegovina, Bulgaria, Kroacia, Qipro, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Gjibraltari, Greqia, Hungaria, Irlanda, Italia, Kosova, Letonia, Lihtenshtejni, Lituania, Luxemburgu, Maqedonia e Veriut, Malta, Monako, Hollanda, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Republika e San Marinosit, Serbia, Slovakia, Slovenia, Spanja, Suedia, Zvicra, Turqia (pjesa europiane), Mbreteria e Bashkuar, Vatikani.

Neni 6 – Procedura

6.1 Në rast aksidenti, defekti teknik në mjetin motorik, apo bllokim rruge nga moti i keq, i siguruari do kontaktojë call center e SIGAL UNIQA në numrin e telefonit të shënuar në policën AutoSOS (+35544522666), dhe do

ndjekë instruksionet e dhëna nga operatori lidhur me marrjen e shërbimit direkt nga partnerët e SIGAL UNIQA në Shqipëri, Kosovë, Mal i Zi, Maqedoni e Veriut apo në vëndet e tjera të Europës, të përcaktuar në pikë nr.5 të kësaj kontrate. 6.2 Në momentin e thirrjes për suport, klienti duhet të japin këto detaje. a.numrin e policës, b.numrin e shasisë së mjetit, c.emrin e të siguruarit, d.llojin e automjetit, e.numrin e telefonit mobile, f.adresen mail, g.pozicionin gjeografik ku ndodhet (location) dhe info te tjera që mund të kërkoehen nga operatori. 6.3 Nëse klineti refuzon të japë të dhënat e mësipërme, atëherë operatori ka të drejtë të refuzojë shërbimin e kërkuar. 6.4 Nëse kosto e shërbimit të ofruar tejkalon limitet e përcaktuara në policë, atëherë diferenca nga vlera e përcaktuar në policë duhet të paguhet nga vetë klienti. 6.5 Pagesat e ndryshme si pagesa e taksë për përdorimin e rrugës apo pagesa të tjera të ngajshme, do të përfshihen në limitin e përcaktuar në policë.

Neni 7 – Përfashtime

7.1 Përfashtohen mjetet me më shumë se 9 vënde, mjetet e destinuara për transport mallrash me peshë totale mbi 3.5 ton. 7.2 Nuk mbulohen mjetet më të vjetra se 20 vite në qarkullim. 7.3 Nuk mbulohen rastet e bllokimit të rrugës kur është e pamundur të udhëtohet në rast trafiku ose kushtet e rënduara të motit (pamundësi e qarkullimit me karroatrec). 7.4 Nuk mbulohen mjetet e siguruara me AutoSOS, nëse kalojnë në shtigje rrugësh apo qarkullojnë në rrugë të painventarizuara (hapësira jo për qarkullim mjetesh). 7.5 Nëse mjeti i siguruar ka konsumuar numrin e shërbimeve (ngjarjeve) të parashikuara ne policë pë periudhë e siguruar. 7.6 Kushtet e marrjes ne sigurim TPL, Karton Jeshil, Kufitare ose Kasko nuk afektojnë në çfarëdo mënyre kushtet e sigurimit AutoSOS.

Neni 8 - Mbrojtja e të dhënave personale

I siguruari është njohur me deklaratën e privatesise të shoqërisë së sigurimeve dhe autorizon SIGAL Insurance Group sh.a që të mbledhë dhe përpunojë të dhënat dhe informacionin personal, i cili nevojitet për administrimin e kontratës së sigurimit, për dhënien e shërbimeve ndaj të siguruarit dhe përfituesit, për ofrimin e produkteve apo shërbimeve të reja, bazuar në ligjet përkatëse në fuqi (Ligji Nr. 9887, date 10.03.2008, *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*) si dhe transferimin e të dhënave personale tek të tretë për qëllime të sigurimit apo biznesi të cilët garantojnë gjithashtu mbrojtjen e të dhënave personale. Në çdo rast, mbrojtja e të dhënave personale do të behet ne perputhje me rregullat dhe procedurat e percaktuara ne Ligj Nr. 9887, date 10.03.2008, *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*.

Neni 9 - E drejta e informimit

I siguruari ka të drejtën të informohet nga Siguruasi mbi kushtet, procedurat dhe afatet e mbulimit dhe/ose përfitimit nga sigurimi, informim i cili fillon para nënshkrimit të kontratës dhe vazhdon gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës. Informimi merret nëpërmjet telefonit, e-mailit, faqes zyrtare në internet apo broshurave informative të përdoruara nga shoqëria. I siguruari është informuar nga Siguruasi përpara nënshkrimit të kontratës së sigurimit, duke marrë të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me të dhënat juridike të siguruesit, llojin përkatës të sigurimit, procedurat, afatet, metodat e trajtimit të kërkesave për dëmshpërbim, rreziqet e mbuluara dhe të përjashtuara, metodat e llogaritjes, afatet dhe mënyra e pagesës së primit, metodën e llogaritjes së vlerës së kompesueshme dhe çdo informacion tjetër që ka lidhje me kontratën e sigurimit.

Neni 10 – Konfidencialiteti

Secila palë pranon të mbrojë nga zbulimi ndaj çdo pale të tretë dhe të mbajë në fshehtësi të gjithë informacionin e marrë nga çdo palë tjetër dhe të përdorë të gjithë informacionin e tillë vetëm për qëllimet e kësaj Kontrate, gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj kontrate. Palët janë të detyruara të respektojnë legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 11 - Forca Madhore

Nëse ndodh një ngjarje e Forcës Madhore e cila pengon palët të përmbushin detyrimet e tyre sipas kësaj Kontrate, Pala e prekur nuk do të ketë detyrime ndaj Palës tjetër dhe do të çlirohet nga detyrimet e saj gjatë periudhës së ekzistencës së Forcës Madhore, me kusht që Pala e prekur të ketë marrë masat përkatëse për të parandaluar ngjarjen e Forcës Madhore, të bëjë përpjekjet e saj maksimale për të minimizuar pasojat negative që mund të sjellë mos përmbushja e detyrimeve të saj sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12 - E drejta për t'u ankuar për shërbimin e ofruar

Klienti apo persona të tjerë të interesuar, kanë të drejtë të paraqesin një ankesë pranë shoqërisë së sigurimit, në rast se çmojnë se shoqëria e sigurimit nuk u përmbahet kushteve të vendosura në kontratën e sigurimit AutoSOS. Ankesa mund të paraqitet në formë elektronike (e-mail) ose me shkrim ne adresën postare të shoqërisë. Shoqëria e sigurimit do ti përgjigjet çdo ankese të depozituar me shkrim apo në formë elektronike dhe do të japë çdo informacion të kërkuar që ka lidhje me kontratën e sigurimit, brënda afateve të percaktuara në ligj.

Neni 13 - Parashikime të tjera të kontratës (Territori i mbulimit në sigurim)

Mbulimi i dhënë nga kjo kontratë është i vlefshëm brënda dhe jashtë territorit të Shqiperise sipas përcaktimeve të nenit 5 të kësaj kontrate.

Neni 14 - Shkelja e detyrimeve kontraktore

Mospërmbushja ose shkelja e parashikimeve të kësaj kontrate do t'i bëjë të pavlefshme kërkesat për pagesë/përfitim.

Neni 15 – Juridiksioni

Çdo mosmarrëveshje mbi kushtet dhe parashikimet dhe mbi këtë kontratë që nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim midis palëve do të jetë subjekt i legjislacionit të Republikës së Shqipërisë dhe do të jetë në juridiksionin e Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm të rrethit Tiranë.

Neni 16 - Të tjera, Kufizimet e Sanksioneve dhe Klauzola Përjashtuese

Pavarësisht dispozitave tjera të kësaj kontrate, kjo kontratë sigurimi ofron mbulim për aq sa mbulimi me sigurim nuk është në kundërshtim me asnjë sanksion ekonomik, tregtar ose financiar dhe/apo embargo të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KB), të Bashkimit Evropian (BE), ose ndonjë ligji apo legjislacioni vendor i aplikueshëm për palët e kësaj kontrate. Kjoë gjithashtu është e aplikueshme edhe për sanksionet ekonomike, komerciale ose financiare dhe/ose embargo të lëshuara nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës ose vendeve tjera, për aq sa nuk bien ndesh me legjislacionin e Bashkimit Evropian (BE) ose legjislacionin vendor.

Neni 17 - Asnjë interpretim kundër hartuesit

Palët pranojnë që kjo është një kontratë e negociuar. Fakti që njëra Palë e kontratës ka hartuar kontratën apo një dispozitë të caktuar të saj apo se ajo përfiton nga ajo dispozitë nuk do të përdoret kundër saj në interpretimin e kushteve të kontratës sepse ata kanë miratuar në mënyrë të posaçme çdo dispozitë të kësaj konkrate përfshirë kufizimet dhe përjashtimet nga mbulimi me sigurim dhe i pranojnë.